Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**13.10.2023**	**26.10.2023**	**2023/0778**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.10.2023, OE "DENISI SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0778, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "VB Tofaj & Niva Construction SH.P.K."- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i 4 urave qe qon ne Roshkodol dhe parkut ne Isniq- Komuna e Deçanit" me nr. të prokurimit: "631-23-8944-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 174,372.73 €.

Fazat e procedurës së aktivitetit të prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 24.08.2023

Hapja e tenderëve: 13.09.2023

Njoftim mbi Vendimin e AK-së: 25.09.2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0778 i dt:10.10.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 10 i Udhëzuesit nr.001/2023 për Prokurim Publik

[Tenderi juaj është refuzuar] per keto arsye :

Nuk ka plotesuar: Kapaciteti teknik dhe professional: Deshmia 3. CV-ja- per projektet realizuara pas diplomimit- duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, diplom e noterizuar Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per ke projekt, si dhe Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar ng punedhenesi nuk qëndrojnë sepse është vërtetuar se për Zn. Zelfije Hyseni –Menagjere Projektit nuk posedon kontratë dhe as Marrveshje për angazhim për këtë Projekt si dhe nu figuron as në listën e punëtorve.Andaj Eliminohet nga Konkurenca .

Arsyeja e AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit është e pa bazuar dhe njëkohësisht e paqartë për faktet që do ti sqarojmë si në vijim:

Autoriteti kontraktues në letrën standarde për tenderues të eliminuar e ka cekur se nuk kemi plotësuar kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional si në vijim: Deshmia 3. CV-ja- për projektet e realizuara pas diplomimit- duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, diploma e noterizuar Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, si dhe Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuar nga punëdhënësi, nuk qëndrojnë sepse është vërtetuar se për znj. Zelfije Hyseni-Menagjere e projektit nuk posedon kontratë dhe as marrëveshje për angazhim në këtë projekt si dhe nuk figuron as në listën e punëtorëve, andaj eliminohet nga konkurrenca.

Arsyeja e lartcekur e autoritetit kontraktues për ne është e paqartë, fillimisht për faktin se ne nuk e kemi të qartë se cilën kërkesë të dosjes së tenderit nuk e plotësojmë, pasi që nuk është cekur fare kërkesa, ndërsa për znj. Zylfie Hyseni ne nuk e dijmë se kush është zonja në fjalë pasi që e njëjta nuk figuron tek lista e punëtorëve të prezantuar nga ne në ofertë.

Nëse eventualisht autoritetit kontraktues ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me dokumentet e prezantuara nga ana jonë në lidhje me kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional, atëherë konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë dhe jo të na eliminoj nga ky aktivitet i prokurimit me një arsye krejtësisht të paqartë dhe të paqëndrueshme.
Ne në ofertë kemi prezantuar dokumente të cilat i përmbushin të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe në këtë rast jemi OE i përgjegjshëm dhe është dashur të rekomandohemi për kontratë dhe jo të eliminohemi pa ndonjë bazë ligjore.

Gjithashtu ju sqarojmë se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse sigurimin e tenderit nuk e ka ofruar sipas kërkesës së dosjes së tenderit konkretisht sipas nenit 13.1&13.2 të dosjes së tenderit.
Sigurimi i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk i përmban kushtet thelbësore që duhet ti përmbaj një sigurim i tenderit dhe i njëjti nuk është i përpiluar sipas aneksit 4 të dosjes së tenderit.
Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet dhe tekstin si në vijim ashti siç është përcaktuar në aneksin 4 të dosjes së tenderit:

ANDAJ NE, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total prej: < shuma e sigurisë me fjalë dhe shifra > zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

a. Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;
b. Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;
c. Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:
- *Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;*
- *Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo*
- *Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit.*

Pa kushtet e lartcekura nëse eventualisht do të vije deri të situata kur duhet të konfiskohet sigurimi, atëherë autoriteti kontraktues nuk mund të kërkoj të konfiskohet sigurimi i tenderit.

Në këto raste nuk mund dhe nuk duhet të kërkohen as sqarime shtesë nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, kurse këtë fakt e parasheh neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik ku shkruan: **Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT- Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.**
Autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve është dashur ti analizoj në tërësi dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë e sidomos sigurimin e tenderit, i cili është një nga kërkesat kryesore që duhet përmbushur për tu konsideruar një tender i përgjegjshëm.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka prezantuar sigurimin e tenderit sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe si i tillë nuk mund dhe nuk është dashur të rekomandohet për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku kërkesë ka qenë *"Kërkesa 5. **1(një) Buldozer** , 2(dy)Ekskavator te ndryshem,4 (Kater) Kamion kiper për transport min pesha 12t,1"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Dëshmia 5. Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik si dhe Lista e pajisjeve duhet te jete e noterizuar ku listës së pajisjeve duhet ti bashkëngjiten këto dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapacitetve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas listes se kerkuar në FDT). OE duhet të prezentoj listen me të gjitha deshmitë përkatëse (librezat e qarkullimit valide me afat te regjistrimit për ato paisje që regjistrohen, DUD-at doganor **ose faturat dhe kontratat e shiteblerjes**) për pajisjet, të cilat jane te domosdoshme qe t'i angazhoj për këtë projekt. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët në prezenc te noterit"*.

I njëjti OE nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se në lidhje me buldozerin ka prezantuar vetëm një faturë në mes të VB TOFAK SHPK dhe EUROVIA SHPK, për shitblerjen e buldozerit, mirëpo askund në ofertë nuk figuron kontrata e shitblerjes, ashti siç është specifikuar decidivisht në kërkesën e lartcekur.
Andaj duke u bazuar në këtë fakt përderisa i njëjti nuk ka prezantuar kontratën sipas kërkesës është i qartë fakti se nuk e plotëson kërkesën dhe është i papërgjegjshëm dhe nuk është dashur të rekomandohet për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk e plotëson edhe kërkesat e përshtatshmërisë, ku kërkesë ka qenë *"Kërkesa 4.Operatori ekonomik duhet të jetë I pajisur me ISO – ISO 9001 2015- Certifikimi I sistemit për Menagjimin e Cilesisë - ISO 39001 2012- Sistemi I Menagjimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor – ISO 14001 2015- Sistemi I Menaxhimin Mjedisor.. ISO 45001 2018- Sistemi Për Menaxhimin e Sigurisë dhe shëndetit në punë"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Deshmia 4.Operatori ekonomik duhet të jetë I pajisur me CERTIFIKATË ISO valide- të noterizuara"*.

Në nenin 26 të Udhëzuesit 001/2022 për Prokurim Publik përkatësisht paragrafi 26.1 është përcaktuar si në vijim *"26.4 Secili anëtarë i grupit duhet të përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, neni 65 i LPP-se. Në përputhje me këtë nen, secili anëtarë i grupit duhet të dorëzojë së bashku me tenderin e tyre Deklaratën nën Betim dhe në rast se autoriteti kontraktues ka për qëllim dhënien e kontratës grupit në fjalë, secili anëtar i grupit duhet t'i sjellë vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë në përputhje me nenin 65 të LPP-së të specifikuara në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë"*.
Pra kërkesa e lartcekur në lidhje me ISO duhet të përmbushet nga dy anëtarët e grupit, ndërsa grupi i OE të rekomanduar për kontratë përkatësisht lideri i grupit VB Tofaj SHPK, ka prezantuar ISO standardin 9001-2015 i cili ka pasur validitet deri me dt13.09.2023, pra në të njëjtën ditë kur është bërë hapja e ofertave.
I njëjti në ofertë nuk ka prezantuar ndonjë dëshmi që ka bërë vazhdimin e validitetit të ISO standardit të lartcekur, andaj si i tillë kuptohet qartë se i njëjti nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderi, pasi që ka prezantuar në ofertë një ISO standard pa validitet.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm, ndërsa jemi diskriminuar ne si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë, duke na eliminuar nga aktiviteti i prokurimit pa ndonjë arsye konkrete.

Ne pajtohemi me arsyet e autoritetit kontraktues për eliminimin e grupit të **OE KBC Group SHPK & Berisha Company SH.A,** pasi që siç ka konstatuar edhe AK-ja, i njëjti është OE i papërgjegjshëm.

Ne me dt.02.10.2023 kemi pranuar vendimin e autoritetit kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo AK-ja nuk ka dhënë asnjë fakt konkret dhe të bazuar në dispozita ligjore.

Sa i përket pretendimit tonë ankimor kundrejt OE të rekomanduar për kontratë në lidhje me sigurimin e tenderit, AK-ja e ka cekur se është bërë verifikimi nga ana e AK-së dhe pretendimi nuk qëndron. Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se ne nuk e dijmë se çfarë verifikimi është bërë, mirëpo në këtë rast nuk ka pasur se çka të verifikohet sepse ne e kemi sqaruar qartë se sigurimi i tenderit nuk i përmban kushtet sipas aneksit 4 të dosjes së tenderit dhe nëse do të vije deri të situata kur duhet të konfiskohet sigurimi, atëherë autoriteti kontraktues nuk mund të kërkoj të konfiskohet sigurimi i tenderit.
Pra përderisa i njëjti nuk i përmban kushtet sipas aneksit 4 të dosjes së tenderit neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik, e përcakton qartë se duhet të refuzohet tenderi pa kërkuar informacione shtesë.

Në lidhje me pretendimin tjetër ankimor kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, sa i përket buldozerit, AK-ja e ka cekur se nuk qëndron pretendimi sepse OE ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme. Edhe ky pretendim i autoritetit kontraktues është i pa bazuar për faktin se nëse eventualisht OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar dëshmi të

mjaftueshme, atëherë të njëjtat do të kishin figuruar në ofertë, mirëpo askund në ofertë nuk figuron kontrata për blerjen e buldozerit ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit.
Nëse OE ka prezantuar ndonjë dëshmi shtesë atëherë AK-ja është dashur të na prezantoj dëshmitë e tilla, mirëpo përderisa një gjë të tillë nuk e ka bërë atëherë është i qartë fakti se pretendimi ynë është i bazuar dhe OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Për pretendimin tonë ankimor në lidhje me ISO e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë AK-ja e ka cekur se pretendimi ynë është i pa bazuar për faktin se OE i rekomanduar ka prezantuar ISO e vazhduara brenda afatit me dt.12.09.2023, mirëpo e njëjta nuk ka prezantuar asnjë dëshmi në lidhje me këtë arsyetim të saj.
Nëse eventualisht i njëjti OE ka prezantuar ISO me afat të vazhduar atëherë neve është dashur të na prezantohen dëshmitë e tilla dhe përderisa nuk janë prezantuar atëherë është i qartë fakti se pretendimi ynë ankimor është i qëndrueshëm.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e ka cekur se ka bërë një lëshim teknik tek letra standarde, pasi që janë ndërruar pozicionet me operatorin tjetër të eliminuar. Kur analizohen letrat standarde të OE të eliminuar shihet qartë se arsyet të cilat AK-ja i ka vendosur në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim askund nuk figurojnë tek letrat standarde.

E njëjta në vendimin për refuzim si arsye të eliminimit e ka cekur se kinse ne nuk e plotësojmë kërkesën në lidhje me qarkullimin dhe menaxherin e projektit, mirëpo këto arsye të eliminimit nuk kanë qenë të specifikuar në letrën standarde për tenderues të eliminuar, andaj si të tilla janë arsye të paqëndrueshme dhe njëkohësisht vetëm pretekste të AK-së për eliminimin tonë nga aktiviteti i prokurimit.

Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët, sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së**, sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit

të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesa1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e shkuara nga publikimi i njoftimit për kontratë në vlerë prej jo më pak se 261,000.00€. Në rast konsorciumi te OE ofertus lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjajshme	**Deshmia 1. Një listë të kontratave të Realizuara ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë , duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe të bashkëngjiten referencat ose procesverbalet e pranimeve teknike**
Kërkesa 2. Minimumi i mesatares së fuqisë punëtore së paku nga 15 (pesëmbëdhjetë) punëtorë në tri vitet e shkuara	**Deshmia 2.Deklaratë të mesatares së fuqisë puntore për secilin nga tri vitet e shkuara Të nënshkruar dhe vulosur nga OE.**
Kërkesa 3. Menagjeri i Projektit - Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv 3 vite pervoj pune pas diplomimit,ose bechellor ndërtimtarisë,drejtimi konstruktiv , 5 vite pervoj pune pas diplomimit, Të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekte të realizuara në lëminë e ndërtimit.	**Deshmia 3. CV-ja- per projektet e realizuara pas diplomimit- duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, diploma e noterizuar Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt, si dhe Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punedhenesi**
Kërkesa 4.Inxhinier i diplomuar ose Bachelor i Gjeodezisë me (3)tri vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekte të realizuara në lëminë e ndërtimit	**Deshmia 3. CV-ja- per projektet e realizuara pas diplomimit- duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, diploma e noterizuar Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt, si dhe Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punedhenesi**

Kërkesa 5. 1(një) Buldozer , 2(dy)Ekskavatorte ndryshem,4 (Kater) Kamion kiper për transport min pesha 12t,1	**Dëshmia 5. Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik si dhe Lista e pajisjeve duhet te jete e noterizuar ku listës së pajisjeve duhet ti bashkëngjiten këto dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapacitetve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas listes se kerkuar në FDT). OE duhet të prezentoj listen me të gjitha deshmitë përkatëse (librezat e qarkullimit valide me afat te regjistrimit për ato paisje që regjistrohen, DUD-at doganor ose faturat dhe kontratat e shiteblerjes) për pajisjet, të cilat jane te domosdoshme qe t'i angazhoj për këtë projekt. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët në prezenc te noterit**
Kërkesa 6. Bazë për beton nga një kompani e licensuar ose marrëveshje për furnizim me beton.	**Dëshmia 6.Per (baze betonit, licenca valide e Notertizuara te lëshuara nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale ne pronesi ose ne rast te marreveshjes per furnizim duhet specifikuar projektin dhe kohezgjatjen e tij. Marrëveshja duhet te jetë e Noterizuar**
Kërkesa 7.Specifikimet teknike të detyrueshme , Aneki 1 i dosjes së tenderit.	**Dëshmia 7. Aneksi 1 i dosjes së tenderit ,Specifikimet tenike të detyrueshme , duhet të jetë i nënëshkruar dhe vulosur nga OE**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN

Zyra e Prokurimit

Deçan datë, 02.10.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Deçanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.09.2023 **të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik DENISI SH.P.K.; REA SH.P.K. Rruga e Demostratave nr 8. 51000. Deçan** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **Ndërtimi i 4 urave që qon në Roshkodol dhe parkut në Isniq- Komuna e Deçanit** me Nr. të Prok **631-23-8944-5-2-1 dhe** Nr. i brendshëm **631 23 043 521** nxjerr:

VENDIM

[REFUZOHET] kërkesa për ri-shqyrtim **Grup i Operatorëve Ekonomik DENISI SH.P.K.; REA SH.P.K. Rruga e Demostratave nr 8. 51000. Deçan** të dt. 29.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit titull : **Ndërtimi i 4 urave që qon në Roshkodol dhe parkut në Isniq- Komuna e Deçanit 631 23 043 521** kunder vendimit të AK –së, të datës 25.09.2023 te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .

1. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

Arsyetim

Grup i Operatorëve Ekonomik DENISI SH.P.K.; REA SH.P.K. Rruga e Demostratave nr 8. 51000. Deçan me datë 29.09.2023, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i 4 urave që qon në Roshkodol dhe parkut në Isniq-Komuna e Deçanit** me Nr**631-23-8944-5-2-1** Nr. Brendshëm **631 23 020 111** Autoriteti Kontraktues, me datë 02.10.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN ANKIMORE NR 1.

Komisioni vlersues ka konstatuar se pretendimet e **Grup i Operatorëve Ekonomik DENISI SH.P.K.; REA SH.P.K. Rruga e Demostratave nr 8. 51000. Deçan** në kërkesën për Rishqyrtim të paraqitur me datë **29.09.2023**

Duke pretenduar se **Grup i Operatorëve Ekonomik VB. TOFAJ; NIVA Construction ' SH.P.K. QENDËR. -51050. JUNIK Nuk ka prezentuar Sigurimin e Tenderit sipas kërkesës së dosjes ju informojmë se ky pretendim nuk qëndron dhe është i pabazuar sepse është verifikuar nga ana e AK-së.**

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN ANKIMORE NR 2.

Komisioni vlersues ka konstatuar se pretendimet e **Grup i Operatorëve Ekonomik DENISI SH.P.K.; REA SH.P.K. Rruga e Demostratave nr 8. 51000. Deçan** në kërkesën për Rishqyrtim të paraqitur me datë **29.09.2023**

Duke pretenduar se **Grup i Operatorëve Ekonomik VB. TOFAJ; NIVA Construction ' SH.P.K. QENDËR. -51050. JUNIK Nuk ka plotësuar kërkesën 5, nuk qëndron ngase ka prezentuar dëshmi të mjaftueshme dhe pretendimi juaj është i pabazuar.**

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN ANKIMORE NR 3.

Komisioni vlersues ka konstatuar se pretendimet e **Grup i Operatorëve Ekonomik DENISI SH.P.K.; REA SH.P.K. Rruga e Demostratave nr 8. 51000. Deçan** në kërkesën për Rishqyrtim të paraqitur me datë **29.09.2023**

Duke pretenduar se **Grup i Operatorëve Ekonomik VB. TOFAJ; NIVA Construction ' SH.P.K. QENDËR. -51050. JUNIK ka prezentuar ISO 9001-2015 Me afat të skaduar nuk qëndron nga para shpalljes së vendimit është kërkuar nga ana e AK-së dhe mbrenda afatit është prezentuar Certifikata ISO 9001-2015 e vazhduar nga data 12.09.2023 nje ditë para hapjes së ofertave.Andaj pretendimi juaj është i pabazuar.**

Gjithashtu ju informojmë se për shkak të një gabimi teknik në Letren Standarte Njoftim për Eliminim janë ndërruar pozicionet me operatorin tjetër të eliminuar.

Andaj ju rikujtojmë se ju jeni Eliminuar për këto arsye: Nuk keni plotesuar : Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 340,000.00€, në 3 (tri) vitet e shkuara , në këtë rast konsorciumi, lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit

Ju keni prezantuar një Dokument të ATK ku shkruan *Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve te tjera*, ku gjendja është si vijon:

Qarkullimi për vitin 2022 është 89,765.09 €

Qarkullimi për vitin 2021 është 35,352.61 €

Qarkullimi për vitin 2020 është 58,386.40 €
Totali i gjithë qarkullimit për tri vite është 183,504.10 €
Kjo vlerë e prezantuar nuk i plotëson kërkesën sepse është kërkuar që Lideri të ketë 60% të vlerës 340,000.00€ që i bie 340,000.00€ x 60 % = 204,000.00€.
Pra lideri nuk plotëson këtë vlerë për = 204,000.00€ - 183,504.10€ = 20,495.90€.

si dhe Kapaciteti teknik dhe professional: Kërkesa 3. Menagjeri i Projektit - Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv 3 vite pervoj pune pas diplomimit,ose bechellor ndërtimtarisë,drejtimi konstruktiv , 5 vite pervoj pune pas diplomimit, Të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekte të realizuara në lëminë e ndërtimit. Andaj jeni eliminohet nga konkurrenca. Ndersa ju keni prezantuar si Inxhinier Konstruktiv z. Fatmir (Ali) Ahmetxhekaj i cili është edhe menaxher i projektit nuk i plotëson kushtet sipas kërkesës së AK, sepse titulli i diplomës së prezantuar për inxhinierin në fjalë është BAÇELOR I SHKENCAVE NË INXHINIERI NDËRTIMORE (NDËRTIMTARI) DHE INFRAKTURUKTURË, nuk është Drejtimi Konstruktiv po ashtu ky ka diplomuar me dt: 08.01.2019 e që nuk i ka 5 vite përvojë të punës por 4 vite e 8 muaj.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.
Këshilla juridi

Zyrtari përgjegjës i Prokurimi

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **DENISI SH.P.K.**

Pretendimi 1

OE ankues pretendon se: *"AK në letrën standard për ternderues të eleminuar e ka cekur se nuk kemi plotësuar kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional si në vijim: Dëshmia 3. CV-ja për projektet e realizuara pas diplomimit- duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, diploma e noterizuar Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë project, si dhe Referenca për punët e mëparshme në lëminë e kërkuar të lëshuar nga punëdhënësi, nuk qëndrojnë sepse është vërtetuar se për znj. Zelfije Hyseni-Menagjere e projektit nuk posedon kontratë dhe as marrëveshje për angazhim në këtë projekt si dhe nuk figuron as në listën e punëtorëve, andaj eleminohet nga konkurrenca. Arsyeja e lartë cekur e AK-së për ne është e paqartë, fillimisht për faktin se ne nuk e kemi të qartë se cilën kërkesë të dosjes së tenderit nuk e plotësojmë, pasi që nuk është cekur fare kërkesa, ndërsa për znj. Zylfie Hyseni ne nuk dijmë se kush është zonja në fjalë pasi që e njëjta nuk figuron tek lista e punëtorëve të prezantuar nga ne në ofertë.*

AK ka rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm sepse sigurimi i tenderit që e ka ofruar nuk e ka ofruar sipas kërkesës së dosjes së tenderit konkretisht sipas nenit 13.1&13.2 të dosjes së tenderit. Sigurimi I ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk I përmban kushtet thelbësore që duhet ti përmbaj një sigurim i tenderit dhe I njëjti nuk është përpiluar sipas ankesit 4 të dosjes së tenderit. Në këto raste nuk mund dhe nuk duhet të kërkohen as sqarime shtesë nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, kurse këtë fakt e parasheh edhe neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik."

Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues në vendimin e lëshuar si përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim ka njoftuar OE ankues se është bërë një gabim teknik sa i përket letrave standarde me Operatorin tjetër të eleminuar, pra janë ndërruar vendet gabimisht.

Sa i përket pretendimit se OE i rekomanduar nuk ka ofruar sigurimin e tenderit sipas kërkesave të DT-së si dhe sipas LPP-së, sipas ekspertit shqyrtues pas analizimit të sigurimit të tenderit, garancia e sigurimit nuk është bërë fare në përputhje me Aneksin 4 të Dosjes së Tenderit, pra pikat e rëndësishme si informacioni i gabueshëm ose mashtrues apo tërheqja e tenderit nuk janë të përfshira fare në garancion, pra, ky lloj garancioni nuk i përmban pikat me rëndësi siç janë kërkuar dhe në rastin kur AK konfrontohet me probleme të tilla, do e ketë të pamundur të bëjë konfiskimin e sigurimit të tenderit për faktin se pikat e përfshira në Ankesi 4 nuk janë të përfshira edhe në garancion. Eksperti shqyrtues duke marr parasysh përgjigjen e AK-së të dhënë në kërkesën për rishqyrtim se jemi sqaruar me OE e rekomanduar sa i përket Sigurimit të Tenderit, ka kërkuar përmes komunikimit zyrtar që AK të dorëzoj këtë dokument dhe komunikimet e tjera të cilat janë bërë me OE e rekomanduar, dhe si përgjigje nga AK ka marr që komunikimi është realizuar përmes telefonit për shkak të disa problemeve teknike me platformën e-prokurimi, kështu përmes e-mailit eksperti ka pranuar sigurimin e njëjtë me atë të ofertës së dorëzuar, pra ku të gjitha pikat e garancionit nuk janë në përputhje me Ankesin 4

të DT-së. Duke u bazuar në Udhëzuesin për Prokurimin Publik, në rast se Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DT-së, atëherë Autoriteti Kontraktues duhet të refuzojë tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm. Andaj ky pretendim se OE i rekomanduar nuk ka ofruar sigurimin e tenderit në përputhje me Ankesi 4, është i bazuar.

Pretendimi 2

"OE I rekomanduar është i papërgjegjshëm për faktin se nuk e plotëson kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku kërkesë ka qenë: Kërkesa 5. 1(një) Buldozer, 2(dy)Ekskavatorte ndryshem,4 (Kater) Kamion kiper për transport min pesha 12t,1. Dëshmia 5. Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik si dhe Lista e pajisjeve duhet te jete e noterizuar ku listës së pajisjeve duhet ti bashkëngjiten këto dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapacitetve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas listes se kerkuar në FDT). OE duhet të prezentoj listen me të gjitha deshmitë përkatëse (librezat e qarkullimit valide me afat te regjistrimit për ato paisje që regjistrohen, DUD-at doganor ose faturat dhe kontratat e shiteblerjes) për pajisjet, të cilat jane te domosdoshme qe t'i angazhoj për këtë projekt. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët në prezenc te noterit.

I njëjti OE nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se në lidhje me buldozerin ka preznatuar vetëm një faturë në mes të VB TOFAK SHPK dhe EUROVIA SHPK, për shitblerjen e buldozerit, mirëpo askund në ofertë nuk figuron kontrata e shitblerjes, ashtu siç është specifikuar decidivisht në kërkesën e lartcekur."

Sa i përket këtij pretendimi të ngritur eksperti sqaron se në Dosje të Tenderit, një nga kërkesat e parashtruara nga AK, ka qenë edhe që OE ofertues si dëshmi për kërkesën me numër 5, të sjellin librezat për ato pajisje të cilat regjistrohen si dhe DUD-at doganor ose faturat dhe kontratat e shit-blerjeve për pajisjet të cilat nuk regjistrohen. OE i rekomanduar për pajisjen e parë Buldozer ka sjellë vetëm një faturë të blerjes së kësaj pajisje e cila është shumë në rregull, mirëpo me të nuk ka sjellë edhe kontratën për shit-blerje ashtu siç ka qenë edhe kërkesa e DT-së, më saktësisht po e ritheksojmë edhe njëherë- DUD-at doganor ose faturat "**dhe"** kontratat e shitblerjes. Eksperti konsideron se në rastin konkret OE i rekomanduar nuk i përmbushë me përpikëri kërkesat e DT-së dhe pretendimi i ngritur nga OE ankues është i bazuar.

Pretendimi 3

"OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk e plotëson edhe kërkesat e përshtatshmërisë, ku kërkesa ka qenë: Kërkesa 4.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me ISO – ISO 9001 2015- Certifikimi I sistemit për Menagjimin e Cilesisë - ISO 39001 2012- Sistemi i Menagjimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor – ISO 14001 2015- Sistemi i Menaxhimin Mjedisor.. ISO 45001 2018- Sistemi Për Menaxhimin e Sigurisë dhe shëndetit në punë.Deshmia 4.Operatori ekonomik duhet të jetë I pajisur me CERTIFIKATË ISO valide- të noterizuara. Kërkesat në lidhje me ISO duhet të përmbushen nga dy anëtarët e grupit, ndërsa

grupi i OE i rekomanduar për kontratë, lideri i grupit VB Tofaj SHPK, ka prezantuar ISO standardin 9001-2015 i cili ka pasur validitet deri me datë 13.09.2023, pra në të njëjtën ditë kur është bërë hapja e ofertave. Nuk është prezantuar ndonjë dëshmi se është bërë vazhdimi i validitetit të ISO standardit."

Eksperti sqaron se OE i rekomanduar ka ofertuar me certifikatën e ISO standardeve përkatësisht me certifikatën ISO 9001:2015 me afat të skaduar. Përkatësisht dita e fundit e vlefshmërisë së atij standardi ka qenë data 13/09/2023, pra dita e hapjes së ofertave. AK në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues ka potencuar se OE i rekomanduar ka sjellë certifikatë të re ISO 9001:2015 me afat të vazhduar nga e njëjta datë pra 13/09/2023. Duke e marr parasysh këtë deklaratë, eksperti shqyrtues ka kërkuar përmes komunikimit zyrtar nga AK që të dorëzoj certifikatën ISO 9001:2015 e cila nuk gjendet askund në sistemin e-prokurimi, dhe AK është përgjigjur kërkesës së ekspertit duke dërguar certifikatën ISO 9001:2015 me afat të vazhduar. Kjo certificatë është vazhduar nga data 12/09/2023, pra që është një ditë para hapjes së ofertave dhe sipas ekspertit është plotësisht e pranueshme dhe konsiderohet dokument i vlefshëm përderisa këtë gjë e lejon edhe Udhëzuesi për Prokurimin Publik. Andaj duke u bazuar në atë çfarë sqaruam më lartë, vlerësojmë se ky pretendim i ngritur, nuk është i bazuar.

Pretendim 4

"AK po ashtu ka theksuar se në letrën standarde është lëshuar një gabim teknik ku janë ndërruar pozicionet me operatorin tjetër të eleminuar dhe AK në kërkesën për rishqyrtim si arsye të eleminimit ka përmendur se OE ankues nuk e ka përmbushur kërkesën në lidhje me qarkullimin bankar dhe menaxherin e projektit. Sipas AK qarkullimi total për tre vitet e fundit të OE ankues është 183,504.10 euro, ndërsa sipas DT nuk I përmbushë këto kërkesa sepse është kërkuar që në rast konzorciumi, lideri duhet të ketë 60% të vlerës, e që I bie të jetë 60% e shumës totale prej 340,000.00 euro që do të thotë lideri duhet të ketë qarkullim prej 204,000.00 euro. Pra lideri nuk e plotëson vlerën prej 20,495.90 euro. Po ashtu sipas AK-së, OE ankues nuk ka përmbushur as kapacitetin teknik dhe professional, ku është kërkuar që të ofrohet një Menaxher I Projektit, inxhinier I diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv 3 vite përvoj pune pas diplomimit, ose bachelor I ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Inxhinieri I preznatuar nuk I plotëson kushtet sipas kërkesës sepse tituli i diplomës së prezantuar është Bachelor I shkencave në inxhinieri ndërtimore dhe infrastrukturë, pra nuk është drejtimi konstruktiv dhe po ashtu ky ka diplomuar me datë 08/01/2019 e që nuk I ka 5 vite përvojë pune por 4 vite e 8 muaj. Këto arsye të eleminimit nuk ka qenë të specifikuara në letrën standard për tenderues të eleminuar, andaj si të tilla janë arsye të paqëndrueshme dhe njëkohësisht vetëm pretekste të AK-së për eleminimin tonë nga aktiviteti i prokurimit. "

Pas shqyrtimit me kujdes të këtyre pretendimeve të ngritura nga ana e AK-së dhe dokumenteve të dorëzuar nga OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se në ofertë OE ankues ka dorëzuar një diplomë për menaxherin e projektit me titull Baçelor i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastrukturë. Kërkesat e Dosjes së Tenderit kanë qenë që OE të angazhojnë një menaxher të projektit i cili është inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, në drejtimin konstruktiv që siç mund të shihet nuk i përmbushë kërkesat e parashtruara. Gjithashtu edhe sa i përket përvojës së punës, AK ka kërkuar që nëse menaxheri ka të përfunduar vetëm nivelin Baçelor, i njëjti duhet të ketë 5 vite përvojë pune pas diplomimit, ndërsa menaxheri i

prezantuar nga OE ankues, ka diplomuar me datë 08/01/2019, që do të thotë se deri në datën e fundit për dorëzimin e tenderëve (13/09/2023), ky menaxher ka pasur vetëm 4 vite dhe 8 muaj përvojë pune pas diplomimit. Pra, për thuajse 4 muaj nuk është përmbushur kushti i përvojës së punës prej 5 vitesh të kërkuar sipas DT-së. Kurse sa i përket qarkullimit financiar, kërkesa në DT ka qenë që lideri i konzorciumit duhet të ketë 60% të vlerës së qarkullimit financiar në tre vitet e fundit, dhe sipas arsyetimit të AK-së, se OE ankues nuk e ka përmbushur këtë kërkesë qëndron. Pra OE ankues nuk e ka përmbushur kriterin e qarkullimit financiar në tre vitet e fundit sipas Dosjes së Tenderit, ku në rast të konzorciumit Lideri I grupit duhet të ketë 60% të vlerës së qarkullimit, shumë e cila sipas Deklaratave Tatimore nuk e përmbushë shumën e paraparë prej 204,000 euro.

Duke marr parasysh se anjëri nga Operatorët ofertues nuk i përmbushin kriteret e Dosjes së Tenderit nga ajo çfarë eksperti sqaroi më lartë, atëherë sipas gjendjes faktike në këto rrethana eksperti vlerëson se përderisa nuk ka operator ekonomik të përgjegjshëm me të cilët mund të vazhdohet aktiviteti i prokurimit, i njëjti duhet të anulohet.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **DENISI SH.P.K.**

Agnese Ibrahimi